



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 176
Datë: 23/ 1 / 2019

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në vendimin e Senatit, të datës 10.01.2019, shpall

K O N K U R S

Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të UP "Hasan Prishtina" për semestrin veror të vitit akademik 2018/19

Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime do të bëhet në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, dispozitat e Statutit në fuqi të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (tutje UP), Rregulloren nr. 2/475 të datës 8.9.2017 për vlerësimin e procedurave për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm të UP-së dhe Rregulloren në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.

I. Kushtet e përgjithshme dhe procedura për angazhim

- 1) Procedura e angazhimit bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik sipas kushteve të përcaktuara me Rregulloren nr. 2/475 të datës 8.9.2017 për vlerësimin e procedurave për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP-së.
- 2) Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
 - Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës.
 - Personeli i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionit ka qënë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës dhe nëse fakulteti ka nevojë për angazhimin e tyre. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta. Këshilli i Fakultetit nxjerr vendimin për angazhimin e kësaj kategorie për vitin akademik përkatës.
 - Profesorët vizitorë nga vendet tjera të punësuar në Universitetet respektive (për një numër të caktuar të ligjeratave deri në 1 semestër), me vendim të Senatit.
- 3) Bashkëpunëtorët e jashtëm mund të angazhohen në UP për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve intelektuale për ligjerata dhe ushtrime mbi bazën e një konkursi publik, për pagesë me honorar. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton themelimin të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- 4) UP-ja nuk mund të angazhojë në ligjerata përkatësisht ushtrime asnjë bashkëpunëtor të jashtëm, i cili ka më tepër se një angazhim jashtë UP-së.

II. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm dhe profesorët vizitorë

- 1) Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjerata dhe profesorët vizitorë mund të mbajnë deri në 6 orë në javë.
- 2) Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në 10 orë në javë.
- 3) Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të

jashtëm, për ligjërata në nivelin bachelor mund të angazhohen edhe kandidatët me gradën e Magjistrisë (Mr. Sc.) ose Masterit (MA).

- 4) Pagesa për kategorinë nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet si për bashkëpunëtorin për ushtrime.

III. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- 1) Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a) kërkesën me biografi;
 - b) certifikatën e lindjes (jo më të vjetër se 6 muaj);
 - c) kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatët, të cilët kanë diplomuar jashtë vendi, duhet të sjellin vendimin për nostrifikim-barasvlerën e diplomës përkatëse bachelor, master, magistraturë, doktoratë);
 - d) kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime, lektorit dhe korepetitorit duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe atyre master;
 - e) dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë;
 - f) dëshmitë për angazhimet paraprake në UP ose në ndonjë Institucion të akredituar të arsimit të lartë
 - g) për lëndët mësimore në të cilat ligjëratat ose ushtrimet mbahen në gjuhën angleze apo në ndonjë gjuhë tjetër të huaj është kusht obligativ dorëzimi i dëshmisë për njohjen e gjuhës përkatëse.
 - h) Dëshmi nga gjykata që nuk është nën hetime.
 - i) Kandidatët janë të obliguar që për secilën pozitë që aplikojnë t'i dorëzojnë dokumentet e kompletuara, në të kundërtën nuk do të pranohen fare nga administrata e fakultetit përkatës

IV. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi

- 1) Kandidatët të cilët do të përzgjedhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë dhe kohëzgjatjes së angazhimit.
- 2) Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia akademike përkatëse, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.
- 3) Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në Rregulloren nr. 2/475, dt. 08.09.2017, të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.

V. E drejta e ankesës

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Komisioni i ankesave i përbërë prej 3 ose 5 anëtarëve emërohet nga këshilli i fakultetit dhe në përbërjen e tij nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit.
3. Kandidatet e pakënaqur kanë të drejtë ankesë pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit në këshill të fakultetit.
4. Komisioni i ankesave më së largu 3 ditë pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës të njëjtën ditë e dorëzon në këshill të fakultetit. Këshilli i fakultetit në

afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendos për miratim ose refuzim të tij.

5. **Shqyrtimi i ankesave dhe marrja e vendimit përkatës në këshillin e fakultetit është vendim përfundimtar në nivel të universitetit.**
6. Dekani i fakultetit, pas shqyrtimit të ankesave eventuale, në mbledhjen e parë të Senatit i njofton Senatorët me listën e kandidatëve të angazhuar.
7. Dekani i fakultetit, në bazë të nenit 72, paragrafi 2 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe vendimit nr. 2/58, dt. 11. 07. 2017 të Këshillit Drejtues autorizohet ta përfaqësojë universitetin në emër të fakultetit lidhur me vendimet e marra në përputhje me këtë rregullore.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje të fortë në fakultetin përkatës (adresat e fakulteteve gjenden nëpërmes web-faqes së universitetit) dhe të skanuara në adresën elektronike punesimi.akademik@uni-pr.edu

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartëcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë ditë) <http://www.uni-pr.edu>, respektivisht prej datës 23.01.2019 deri me datën 06.02.2019 në ora 15:30.

Konkursi shpallet sipas propozimit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore dhe Fakultetit Ekonomik dhe atë si në vijim:

I. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: Biokimi (O), Bsc. Kimi, Materialet polimere në inxhinierin kimike (Z) Bsc. K. Inxh);
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: (Spektroskopia (O) Bsc. Kimi, Kimi organike II (O) Bsc Kimi);
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndët: (Kimi Organike II (O) Bsc. K. Inxh, Mekanizmat e reaksioneve organike, (O) Msc KO;
4. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndë të matematikës në programet Matematikë dhe Matematikë financiare, për semestrin veror të vitit akademik 2018/2019.

II. FAKULTETI EKONOMIK

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, për lëndën: Matematikë financiare dhe
2. Dy bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndën: Statistika.

